

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1222 Rep.

Nr. Kol.

2109



KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 04.10.2013 (dymijë e trembëdhjetë), përpara meje noteres Majlinda E. Demollari, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me Seli ne Qytetin e Tiranës, Rr. "Vaso Pasha" ish blloku u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm:

1. **Shoqëria "FOCUS GROUP" sh.p.k.** regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 18.04.2011, me Nr. identifikimi NIPT L 11618006J, me Seli ne Rr. "Vaso Pasha", Nr.8, Tiranë, e përfaqësuar nga administratorja **Znj. Fiona Tako**, e bija e Astritit, lindur më 09.03.1985 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me nr. 027452896.

dhe

2. **Shoqëria "PANORAMA GROUP" sh.a** regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 05.09.2002, me Nr. identifikimi NIPT K 22112005E, me Seli ne Rr. "Panorama", Pallati 1, Kati2, ish Elektro-Teknike, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori **Z. Erion Tafaj**, i biri i Bashkimit, lindur më 15.04.1974 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse i Letërnjoftimit ID me nr. 024993654.

Të sipërpërmendurit, bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", statutin e shoqërisë "PANORAMA GROUP" SH.A., statutin e shoqërisë "FOCUS GROUP" SHPK dhe statutin e shoqërisë Shkolla e Larte Universitare Jopublike "Universiteti Luarasi" shpk kërkuan prej meje noteres përpilimin e kësaj "Kontrate për shitje kuotash" si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese

1. **Shoqëria "FOCUS GROUP" sh.p.k.** regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 18.04.2011, me Nr. identifikimi NIPT L 11618006J, me Seli ne Rr."Vaso Pasha", Nr.8, Tiranë, e përfaqësuar nga administratorja **Znj. Fiona Tako**, e bija e Astritit, lindur më 09.03.1985 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me nr. 027452896, **nga këtu e më poshtë referuar si "SHITËSI"**,

dhe

2. **Shoqëria "PANORAMA GROUP" sh.a** regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 05.09.2002, me Nr. identifikimi NIPT K 22112005E, me Seli ne Rr. "Panorama", Pallati 1, Kati2, ish Elektro-Teknike, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori **Z. Erion Tafaj**, i biri i Bashkimit, lindur më 15.04.1974 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse i Letërnjoftimit ID me nr. 027993654 **nga këtu e më poshtë referuar si "BLERËSI"**.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi te Blerësit, të **100 % (një qind përqind) të kuotave** që Shitësi zotëron si ortak i vetëm në shoqërinë Shkolla e Larte Universitare Jopublike "Universiteti Luarasi" shpk.

Neni 3

Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi, sipas marrëveshjes midis palëve, është **400.000 Euro (katër qind mijë Euro)**.

Neni 4

Mënyra e pagesës

4.1 Palët deklarojnë që pagesa e çmimit të shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate do të bëhet, sipas kësteve të përcaktuara në nenin 4.2, me transaksion bankar nëpërmjet CREDINS Bank në llogarinë e Shitësit shoqëria "FOCUS GROUP" sh.p.k.

4.2. Shuma prej 400.000 Euro do të paguhet në afatet si më poshtë:

- a) Kësti i parë prej 200.000 Euro do të paguhet brenda datës 31.10.2013;
- b) Kësti i tretë prej 100.000 Euro do të paguhet brenda datës 30.11.2013;
- c) Kësti i fundit prej 100.000 Euro do të paguhet brenda datës 31.12.2013.

Pronesia mbi 100% të kuotave, sipas kësaj kontrate, kalojnë tek Shitesi me nënshkrimin e kësaj kontrate. Por, regjistrimi i tyre do të bëhet i barresuar në favor të Shitesit deri në shlyerjen e plote të çmimit të blerjes së kuotave. Për shkak të ligjit, Shitesi konsiderohet barremarres mbi 100% të kuotave – objekt i kësaj kontrate – që përbejnë kolateral dhe garanci në favor të tij deri në shlyerjen përfundimtare të çmimit të blerjes, brenda afateve të mesiperme.

Neni 5

Detyrimet e shitësit

Shitësi pranon çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë Shkolla e Lartë universitare jopublike "Universiteti Luarasi" SHPK, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barrë dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Neni 7

Hyrja në fuqi



Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate ortak i vetëm i shoqërisë Shkolla e Larte Universitare Jopublike "Universiteti Luarasi" shpk do të jetë shoqëria "Panorama Group" Sh.A.

Neni 8

Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 5 ekzemplare në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një ekzemplar të kontratës dhe një ekzemplar do të depozitohet pranë selisë së shoqërisë Shkolla e Larte Universitare Jopublike "Universiteti Luarasi" shpk.

Neni 9

Pas përpilimit të kësaj kontrate, Unë noterja e lexova atë me zë të lartë. Shitësi dhe Blerësi, më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e pranuan dhe e nënshkruan atë në praninë time.

SHITËSI

Shoqëria "FOCUS GROUP" sh.p.k

Administratör

Zj. FIONA TAKO

Fiona Tako



BLERËSI

Shoqëria "Panorama Group" sh.a

Administratör

Z. ERION TAFAJ

Erion Tafaj



NOTERE

MAJLINDA E. DEMOLLARI